



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Nr. 50 / Prot.
54

Tiranë, më 30.09.2024

Lënda: Raporti i Monitorimit të Buxhetit për periudhën Janar-Gusht të vitit 2024.

**MINISTRISË SË FINANCAVE
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BUXHETIT
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BUXHETIT**

TIRANË

Në mbështetje të Ligjit nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, në vijim të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në NJQQ”, lutemi gjeni bashkëlidhur Raportin e Monitorimit të Buxhetit të 8-mujorit të parë të vitit 2024 të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Raporti i monitorimit të tetë mujorit Janar–Gusht 2024 krahas analizës së shpenzimeve buxhetore në nivel programi përmban dhe një analizë të objektivave institucionale referuar performancës buxhetore të orientuar drejt rezultateve.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Valbona Gaxha



HYRJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit, kryen në mënyrë të vazhdueshme monitorimin e treguesve buxhetore, nëpërmjet vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore dhe krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuar më qëllim realizimin e objektivave të synuara dhe të përcaktuar në Deklaratën e Politikës së Programit të KLSH-së të përfshirë në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2023-2027.

Nëpërmjet këtij raporti monitorimi evidentohet niveli i realizimit të fondeve buxhetore të KLSH-së të detajuar në nivel kategori shpenzimi buxhetor kundrejt treguesve të planifikuar duke mundësuar në këtë mënyrë riorientimin dhe sigurimin e një informacioni shtesë për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe të menaxhimit të buxhetit.

Në mbështetje të Ligjit nr.97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, dhe në vijim të udhëzimit të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.07.2018, “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në NJQQ”, për periudhën **Janar-Gusht 2024**, performanca e realizimit të buxhetit, paraqitet si më poshtë:

PROGRAMI 01120 “VEPRIMTARI AUDITUESE E KLSH-së”

Buxheti i akorduar për programin “Veprimtari audituese e KLSH-së”, ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës të hartuar gjatë procesit të PBA 2024-2026 dhe është në funksion të kësaj Deklarate. Politika buxhetore e KLSH-së është fokusuar në përmbushjen me cilësi të lartë dhe në kohë të detyrimeve ligjore, të objektivave, si dhe prioritetëve të institucionit të parashikuar në Planin e Zhvillimit Strategjik 2023-2027, duke konsideruar kërkesat e organizmave ndërkombëtarë të auditimit dhe të BE-së të përcaktuara në MSA-në e Shqipëri-BE dhe të monitoruara në kuadrin e Integritimit Evropian.

“RAPORTI I SHPENZIMEVE FAKTIKE TË PROGRAMIT SIPAS ARTIKUJVE PËR PERIUDHËN JANAR-GUSHT 2024”

Në zbatim të Ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, buxheti i miratuar për vitin 2024, për institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit është në vlerën për 684,000 mijë lekë dhe është shtuar në zërin 606- “Ndihmë Financiare” në vlerën për 1,500 mijë lekë në.

Shpenzimet e planifikuara për funksionimin e aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, sipas zërave për vitin 2024, paraqiten si më poshtë:

- Shpenzime për Paga dhe Sigurime në vlerën për 598,100 mijë lekë ose 88 % e buxhetit të planifikuar
- Shpenzime për mallra dhe Shërbime në vlerën për 70,900 mijë lekë ose 10 % e buxhetit të planifikuar
- Shpenzime Kapitale me Financim të Brendshëm në vlerën për 15,000 mijë lekë ose 2 % e buxhetit të planifikuar
- Gjithashtu, KLSH, ka trashëguar nga viti 2023 Grandin Kapitale me Financim të Huaj, në vlerën për 3,181 mijë lekë ose 0.5. % e buxhetit të planifikuar

Bazuar në nevojat për mjete financiare plani vjetor i buxhetit është rishpërndarë brënda zërave të shpenzimeve korente dhe kapitale. Tabela në vijim paraqet planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve buxhetore për periudhën janar-gusht 2024.

Kap	Art	Kod Projekti	Kod Projekti	Plani Vjetor	Rishperndarj e nr. 8847/1, date 03.07.2024	Rishperndarj e nr.9902/1, Date 25.07.2024	Plani me ndryshime	Plani 8 Mujori	Fakti 8 Mujori	Diferenca	%
01	600	92401AA	Paga	531,300,000	-10,000,000		521,300,000	342,000,000	303,569,374	38,430,626	89%
01	601	92401AA	Sigurime	66,800,000			66,800,000	47,000,000	46,345,918	654,082	99%
	600+601		Paga dhe Sigurime	598,100,000	-10,000,000		588,100,000	389,000,000	349,915,292	39,084,708	90%
01	602	92401AA	Mallra dhe sherbime	70,500,000	10,000,000		80,500,000	57,750,000	45,556,289	12,193,711	79%
01	605	92401AA	Transferta me jashte	400,000			400,000	400,000	292,166	107,834	73%
01	606	92401AA	Ndihma	1,500,000			1,500,000	1,500,000	421,200	1,078,800	28%
	602,605,6		Mallra dhe Sherbime	72,400,000	10,000,000		82,400,000	59,650,000	46,269,655	13,380,345	78%
01	231	M240009	Paisje informatike	4,200,000			4,200,000	4,200,000	0	4,200,000	
01	231	M240002	Mjete transporti	5,200,000			5,200,000	5,200,000	0	5,200,000	
01	231	M240003	Rikonstruksion ndertesave	1,600,000		-1,600,000	0	0	0	0	0
01	231	M240010	Paisje Zyre	2,000,000			2,000,000	2,000,000	0	2,000,000	
03	230	19AA402	Kosto Lokale	1,000,000		780,000	1,780,000	1,780,000	0	1,780,000	
04	230	M24008	TVSH	1,000,000		820,000	1,820,000	1,820,000	0	1,820,000	
	231		Investime	15,000,000	0	0	15,000,000	15,000,000	0	15,000,000	0%
			Totali	685,500,000	0	0	685,500,000	463,650,000	396,184,947	67,465,053	85%

Shpenzimet e planifikuara të 8-mujorit në vlerën totale për 463,650 mijë lekë janë realizuar në vlerën për 396,185 mijë lekë ose në masën për 85 %.

ANALIZA E REALIZIMIT TË BUXHETIT TË KLSH-SË PËR PERIUdhËN JANAR-GUSHT 2024

1. Shpenzime Personeli. Llogaria 600-601.

Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2024 në zbatim të Ligjit nr.97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", për zërin "Paga dhe Sigurime" është në vlerën për 598,100 mijë lekë dhe numri i miratuar i punonjësve të KLSH-së për vitin 2024 është 243 punonjës.

Për periudhën progresive Janar-Gusht, buxheti i planifikuar në masën për 389,000 mijë lekë është realizuar në vlerën për 349,915 mijë lekë ose realizuar në masën 90%.

Shuma e shpenzuar në zërin Shpenzime Personeli, përfshin pagat e punonjësve të KLSH-së dhe të ekspertëve të jashtëm të përkohshëm të kontaktuar dhe paguar konform shkresave dhe kontratave të nënshkruara me ta.

2. Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera. Llogaria 602.

Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2024 në zbatim të Ligjit nr.97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", për zërin shpenzime operative, është në vlerën për 70,900 mijë lekë, ose 10 % e planit buxhetor të vitit 2024.

Plani për periudhën Janar-Gusht në vlerën për 59,650 mijë lekë është realizuar në vlerën për 46,269 mijë lekë ose është realizuar në masën 78 %.

Me këtë zë shpenzimesh janë përballuar mbulimi i nevojave administrative të shpenzimeve si shpenzime për shërbimin e sigurisë, drita, ujë, telefon, kancelari, bateri për ups etj. Një pjesë të konsiderueshme në shpenzimet operative e zënë shpenzimet për udhëtim e dieta brenda vendit në vlerën për 29,902 mijë lekë dhe që përfaqësojnë 65% të shpenzimeve faktikë korente.

Aktualisht, për vitin 2024, KLSH, ka realizuar disa procedura prokurimi në lidhje me:

-Rinovim suportit të licenca të Firewall dhe E-Mail Security. Prokurimi i rinovimit të licencave të sipërpërmendura i ka shërbyer KLSH-së për funksionimin optimal të pajisjeve të teknologjisë së informacionit, rritjen e sigurisë së rrjetit si dhe lehtësimin e punës së përdoruesve të infrastrukturës teknologjike të KLSH-së.

-Shërbim interneti për institucionin, mirëmbajtje ashensori, mirëmbajtje sistem alarmi, mirëmbajtje kondicionerësh, shërbim dhe pjesë këmbimi automjete, etj. Kontrata të cilat vijojnë të likujdohen gradualisht gjatë vitit në përputhje me kushtet kontraktuale. KLSH, vazhdon me procedurat e prokurimit.

2.1 Transferta korrente dhe të huaja. Llogaria 605.

Për periudhën raportuese 2024, janë shlyer detyrimet për kuota anëtarësimi për organizatat INTOSAI dhe EUROSAI, si dhe kuotat e pjesëmarrjes në aktivitetet ndërkombëtare në shumën 292 mijë lekë nga 400 mijë lekë të planifikuara.

3. Transferta për buxhetet familjare. Llogaria 606.

Gjatë periudhës ushtrimore 2024, është dhënë Fond i Veçantë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në vlerën 1,500 mijë lekë, për daljen e punonjësve në pension, rast fatkeqësie dhe sëmundjeje vlerë e cila përgjatë kësaj periudhe nuk është shpenzuar. Ky fond, në mbyllje të periudhës 8-mujore, është realizuar në vlerën për 421,200 lekë, ose është realizuar në masën për... % të buxhetit vjetor.

4. Shpenzime për investime kapitale. Llogaria 230-231.

• Bazuar në Ligjin nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, fondi i miratuar për Shpenzime Kapitale është vetëm për Shpenzime Kapitale me Financim të Brendshëm në vlerën për 15,000 mijë lekë. Detajimi dhe rishpërndarja e fondeve buxhetore të miratuara në këtë zë, është kryer duke mbajtur në vëmendje nevojat për shpenzime kompjuterike, rikonstruksion ndertesa, kostot lokale dhe tvsh për projektin me financim të huaj si dhe nevojat për paisje zyre. Për periudhën raportuese janar-gusht 2024, këto zëra shpenzimesh nuk kanë patur realizim. Tabela në vijim paraqet planifikimin e investimeve kapitale me Financim të Brendshëm.

Kodi i Projektit	Pershkrimi	Plani Vjetor	Në mijë lekë
M240009	Paisje kompjuterike		4,200,000
M240002	Automjete		5,200,000
M240010	Paisje Zyre		2,000,000
19AA402	Kosto Lokale		1,780,000
M24008	TVSH		1,820,000
	Totali		15,000,000

Gjatë kësaj periudhe:

KLSH po vijon procedurat e prokurimit në lidhje në vlerën 5,200 mijë lekë për blerje automjeti,

• Përveç fondeve buxhetore, KLSH, ka trashëguar nga viti 2023 Grandin Kapitale me Financim të Huaj, në vlerën për **3,181 mijë lekë**.

-Vlera për 267 mijë lekë, është trashëguar si diferencë e mbetur nga viti 2022, dhe i takon të ardhurave nga donatori INTOSAI, grand i cili ka patur qëllim të sigurojë mbështetje afatshkurtër përmes zgjidhjeve të TIK-ut, trajnimeve dhe pajisjeve të sigurisë së stafit për të mundësuar vazhdimësinë e operacioneve të SAI të ndikuara nga COVID-19.

-Gjatë periudhës Dhjetor 2023, ne kemi arkëtuar të ardhurat nga Institucioni Suprem i Auditimit të Arabisë Saudite me qëllim mbështetjen shtesë në zhvillimin dhe zgjerimin e infrastrukturës ITC (IT dhe Komunikim) në vlerën për 2,914,008.33 lekë.

Aktualisht, KLSH po vijon procedurat e prokurimit në lidhje me realizimin e projekteve duke përdorur njëkohësisht fondet e buxhetit të shtetit dhe njëkohësisht dhe grandin e huaj.

- Gjithashtu, përgjatë periudhës 8-mujore, ka vijuar normalisht, zbatimimi i projektit të investimit me Financim të Huaj “Forcimi i rolit të Auditimit të Jashtëm në mbikëqyrjen e partneritetit publik-privat në Shqipëri”. Ky projekt do të bëjë të mundur krijimin e eksperiencave të reja dhe do të përsosë njohuritë dhe aftësitë e audituesve të KLSH-së për të mbikëqyrur fushën e koncesioneve dhe kontratave të partneritetit publik-privat duke sjellë dhe plotësimin e një kornize të përshtatshme për të siguruar që këto lloj kontratash ofrojnë vlerë të shtuar dhe minimizojnë risqet në kushtet e financimit publik. I gjithë ky proces nuk mund të bëhet pa garantuar që audituesit kanë aftësitë e duhura teknike lidhur me përdorimin e mjeteve të teknologjisë së informacionit në auditim. Projekti do të mundësojë auditime më cilësore dhe do të japë rekomandime me vlerë të shtuar në mirë menaxhimin e kontratave të PPP-ve, duke përmirësuar dhe kuadrin ligjor të realizimit të tenderimit publik përkatës dhe të lidhjes dhe zbatimit të kontratave koncesionare. Ky projekt dy vjeçar do të ndihmojë dukshëm në drejtim të auditimit më profesional të fondeve publike në fushën e koncesioneve dhe PPP-ve në Shqipëri.

ANALIZA E OBJEKTIVAVE INSTITUCIONALE, REFERUAR BUXHETIT TË ORIENTUAR NË REZULTATE PER PERIUDHEN JANAR-GUSHT2024.

KLSH përgjatë vitit 2024 vijoi veprimtarinë menaxheriale institucionale suportuar nga një qeverisje e brendshme efektive dhe mirëfunksionimi të sistemeve të kontrollit të brendshëm duke siguruar përputhshmërinë me standardet e kontrollit të brendshëm me qëllim sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe përbushjen e objektivave Strategjike në nivelin e pritshmërive të synuara drejt konsolidimit të reformave të ndërmarra, në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit, ISSAI, me rekomandimet e Progres Raporteve të BE, me detyrimet kushtetuese dhe me pritshmërinë e Kuvendit, publikut dhe të gjitha palëve të interesit.

I. MISIONI, VIZIONI DHE OBJEKTIVAT E KLSH-së

Kontrolli i Lartë i Shtetit është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar. Ai i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjeve.

Misioni

Kontrolli i Lartë i Shtetit është institucion i pavarur, kushtetues, i cili nëpërmjet ekspertizës dhe auditimeve cilësore, mbështet Kuvendin dhe informon publikun dhe palët e interesit në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë mbi përgjegjshmërinë që qeveria dhe entet publike tregojnë në menaxhimin e parasë së taksapaguesve, me qëllim përmirësimin e shërbimeve publike.

Vizioni

KLSH është një institucion model që udhëheq nëpërmjet shembullit, që nxit rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës, dhe përmirësimin e shërbimeve publike, nëpërmjet auditimeve cilësore dhe luftës kundër korrupsionit, duke forcuar integritetin dhe besimin e publikut tek institucioni.

Objektivat:

Tre qëllimet strategjike që do të udhëheqin punën e KLSH-së në pesë vitet e ardhshme janë:

1. Rritja dhe përmirësimi i rolit të KLSH si mbështetës i Kuvendit për llogaridhënie efektive dhe shqyrtim të kujdesshëm e të thelluar të enteve përdoruese të fondeve publike.
2. Rritja e impaktit të punës audituese në qeverisjen e mirë, nëpërmjet përmirësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve.

3. Optimizimi i kapaciteteve profesionale me qëllim zotërimin e njohurive inovative në punën audituese.

MBI REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE TË MENAXHIMIT INSTITUCIONAL.

A-Treguesit kryesore të veprimtarisë audituese.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, për periudhën janar-prill 2024, ka vijuar punën audituese në zbatim të planit të miratuar me Vendimin nr.210, datë 18.12.2023 të Kryetarit të KLSH, duke kryer dhe evaduar 80 misione auditimi, në vlerësim të përputhshmërisë, rregullshmërisë financiare, performancës dhe ndjekjes së statusit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në periudha të mëparshme. Përgjatë kësaj periudhe, janë kryer auditime financiare, përputhshmërie, të kombinuar, performance, IT.

Institucionet ku janë kryer auditimet

Në periudhën janar-gusht 2024, auditimet e kryera kanë përfshirë vlerësimin e aktivitetit duke përfshirë nivele të ndryshme të qeverisjes si: institucione qendrore, ministri dhe agjenci (përfshirë drejtori qendrore dhe rajonale në varësi të tyre), njësi të vetëqeverisjes vendore, drejtori të përgjithshme të administrimit fiskal, si dhe shoqëri aksionare me kapital shtetëror në të cilën shteti a mbi 50% të aksioneve, apo projekte me financim të huaj.

Opinionet/mesazhet/konkluzionet sipas llojit të auditimit. Bazuar në planin vjetor, Kontrolli i Lartë i Shtetit, për periudhën janar-gusht 2024, ka përfunduar kryerjen e 80 auditimeve, duke dhënë opinione dhe mesazhe:

- Opinione të pamodifikuar (Financiare & Përputhshmërie)
- Opinione të modifikuar (Financiare & Përputhshmërie)
- Konkluzione për çështje të veçanta

Përmirësimet Ligjore dhe Masat Organizative. Gjatë periudhës janar – gusht 2024, për 80 auditimet e përfunduara, KLSH ka adresuar rekomandime për masa organizative dhe propozime për ndryshime apo përmirësime ligjore, në institucionet publike të audituara, me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e situatës.

Gjetje me efekte financiare negative në buxhetin e shtetit. Gjatë periudhës janar- gusht 2024, janë dhënë rekomandime mbi gjetje me efekte negative në buxhetin e shtetit, të ndara sipas zërave në: dëmi ekonomik, menaxhimi jo efektiv i fondeve, mangësi në aktivitetin kontrollues tatimor/doganor.

Masa disiplinore dhe administrative. Bazuar në Ligjin Nr.154, atë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, KLSH, për të metat dhe shkeljet e konstatuara, ka adresuar tek subjektet e audituara masa disiplinore dhe administrative,

Masa disiplinore. Konkretisht, për shkeljet e konstatuara në bazë të ligjit të mësipërm, Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, neni 58 dhe kodit të punës.

Masa Administrative. Bazuar në Ligjin Nr.154, atë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, KLSH, për të metat dhe shkeljet e konstatuara, ka adresuar tek subjektet e audituara masa administrative. Konkretisht, për shkeljet e konstatuara, KLSH, u ka kërkuar organit respektiv Agjencisë së Prokurimit Publik, shqyrtimin dhe marrjen e masave administrative.

Nga rezultatet e auditimeve, gjatë kësaj periudhe, gjetjet e konstatuara i referohen:

- Parregullsive dhe mangësive në zbatimin e disiplinës buxhetore në programimin dhe realizimin e shpenzimeve publike, likuidimin e shpenzimeve përfshirë dhe ato për investime, krijimin e detyrimeve të prapambetura etj.;
- Përdorimit të fondeve pa efektivitet, ekonomicitet dhe eficiencë kryesisht në fushën e prokurimit publik, për shkak të mangësive në realizimin e procedurave të cilat në shumë raste rezultojnë se nuk kryhen në përputhje të plotë me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi;

B- Mbi trajnimet e realizuara gjatë periudhës Janar-Gusht 2024.

Gjatë periudhës janar-gusht 2024, u realizuan 129 tema trajnimesh, nga të cilat 48 organizuar nga ASPA & partnerë lokal dhe 52 nga KLSH & partnerë ndërkombëtarë si EUROSAI, IDI, CEF, SAI-e homologe, etj. U trajnuan gjithsej 170 auditues, duke realizuar mesatarisht 16 dite trajnimi/auditues për periudhën 8 mujore (nga 12-16 ditë trajnimi që është objektivi 8 mujor).

Ndër temat kryesore objekt trajnimi gjatë vitit 2024, rendisim: tema që prekin çështjet mjedisore (si industria nxjerrëse, burimet ujore), tema mbi çështje të integritetit, forcimi i kapaciteteve audituese për auditimin e koncesioneve/PPP-ve, siguria e informacionit dhe krimi kibernetik dhe përmirësimi i aksesit me standarde të larta në shërbimet publike nëpërmjet GovTech., të shkruarit e raporteve, menaxhimi i cilësisë së auditimit, mbi manualët e auditimit

Një informacion më i detajuar në lidhje me veprimtarinë e kryer për periudhën Janar-Gusht 2024, jepet në Buletinin Statistikor për periudhën Janar-Gusht 2024, të publikuar në faqen ëeb të KLSH-së.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Valbona Gaxha



ANEKSI nr.1 Raporti Përmbledhës i Shpenzimeve të Ministrisë/Institucionit Buxhetor

Periudha e Raportimit 8-2024

në/lekë

Emri i Grupit Kontrolli Lartë i Shtetit		Kodi i grupit											
		Shpenzimet e Ministrisë/Institucionit											
Kodi i Programit	Emërtimi	Viti paraardhës 2023		Periudha raportuese		Periudha raportuese		Periudha raportuese		Periudha raportuese		Ndryshimi Vjetor (Plan - Fakt)	% e realizimit
		Shpenzime Faktike	Struktura e shpenzimeve në %	Plani Fillestar Vjetor Viti 2024	Struktura e shpenzimeve në %	Plani Vjetor i Rishikuar Viti 2024	Struktura e shpenzimeve në %	Ndryshimi i planit vjetor	Shpenzime Faktike të Periudhës/Progressive	Struktura e shpenzimeve në %	Ndryshimi Vjetor (Plan - Fakt)		
(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7 (5-3))	(8)	(9)	(10 (5-8))	(11 (8/5))			
Shpenzimet sipas programeve buxhetore													
01120	Vepirmtaria Auditive dhe KLSH	552,481,200.90	100	684,000,000.00	100	685,500,000.00	100	1,500,000.00	396,184,947.00	100	289,315,053.00	58	
	Totali i Shpenzimeve buxhetore të Ministrisë (Kap 01.02.03.04.05.08.22)	552,481,200.90	100	684,000,000.00	100	685,500,000.00	100	1,500,000.00	396,184,947.00	100	289,315,053.00	58	
	Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit (Kap 06)	0.00							0.00				
	Totali Shpenzimeve të Ministrisë	552,481,200.90							396,184,947.00				
Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik													
Artikulli Emërtimi													
600	Paga	402,586,583.00	73	531,300,000.00	78	521,300,000.00	76	-10,000,000.00	303,569,374.00	77	217,730,626.00	58	
601	Sigurime Shoqërore	62,524,010.00	11	66,800,000.00	10	66,800,000.00	10	0.00	46,345,918.00	12	20,454,082.00	69	
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	71,423,959.90	13	70,900,000.00	10	80,500,000.00	12	9,600,000.00	45,556,289.00	12	34,943,711.00	57	
603	Subvencione	0.00	0	0.00	0	0.00	0	0.00	0.00	0	0.00	0	
604	Transferita Korente të Brendshme	0.00	0	0.00	0	0.00	0	0.00	0.00	0	0.00	0	
605	Transferita Korente të Huaja	116,035.00	0	0.00	0	400,000.00	0	400,000.00	292,166.00	0	107,834.00	73	
606	Trens per Buxh. Fam. & Individ	643,117.00	0	0.00	0	1,500,000.00	0	1,500,000.00	421,200.00	0	1,078,800.00	28	
	Non-Totali Shpenzime Korrente	537,293,704.90	97	689,000,000.00	98	670,500,000.00	98	1,500,000.00	396,184,947.00	100	274,315,053.00	59	
230	Kapitale të Patpëzuara	1,816,700.00	0	0.00	0	3,600,000.00	1	3,600,000.00	0.00	0	3,600,000.00	0	
231	Kapitale të Trupëzuara	6,053,456.00	1	15,000,000.00	2	11,400,000.00	2	-3,600,000.00	0.00	0	11,400,000.00	0	
	Non-Totali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	7,870,156.00	1	15,000,000.00	2	15,000,000.00	2	0.00	0.00	0	15,000,000.00	0	
230	Kapitale të Patpëzuara	7,317,340.00	1	0.00	0	0.00	0	0.00	0.00	0	0.00	0	
231	Kapitale të Trupëzuara	0.00	0	0.00	0	0.00	0	0.00	0.00	0	0.00	0	
	Non-Totali Shpenzime Kapitale me financim të huaj	7,317,340.00	1	0.00	0	0.00	0	0.00	0.00	0	0.00	0	
	Totali Shpenzime Kapitale	15,187,496.00	3	15,000,000.00	2	15,000,000.00	2	0.00	0.00	0	15,000,000.00	0	
	Totali i Shpenz. Buxhetore të Ministrisë/Institucionit Buxhetor	552,481,200.90	100	684,000,000.00	100	685,500,000.00	100	1,500,000.00	396,184,947.00	100	289,315,053.00	58	
	Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit (Kap 06)	0.00							0.00				
	Totali (Korrente + Kapitale + Shpenz. nga te arch. jashte limit)	552,481,200.90							396,184,947.00				
	Numri i punonjësve	0		0		0		0	0		0		



Emri
Firma
Data

Sekretari i Përgjithshëm

ANEKSI 1.1 Raporti i Shpenzimeve të Ministrisë/Institucionit sipas kapitujve

Periudha e Raportimit 8-2024

Kodi i Ministrisë	Kodi i Kapitullit	Emërtimi i Kapitullit	Periudha raportues e		Buxheti	Artikujt buxhetore							Total
			Periodike /Vjetore	2024		231	600	601	602	605	606	Total	
24	01	Nga Buxheti	0	13,000,000	Plani fillestar	531,300,000	66,800,000	70,900,000	0	0	0	0	682,000,000
24	01	Nga Buxheti	0	11,400,000	Plani i rishikuar	521,300,000	66,800,000	80,500,000	400,000	1,500,000	0	0	681,900,000
24	01	Nga Buxheti	0	0	Fakti	303,569,374	46,345,918	45,556,289	292,166	421,200	0	0	396,184,947
24	01	Nga Buxheti	0	0	Angazhime	0	0	5,041,872	0	0	0	0	5,041,872
24	03	Kosto lokale	1,780,000	2,000,000	Plani fillestar	0	0	0	0	0	0	0	2,000,000
24	03	Kosto lokale	0	0	Plani i rishikuar	0	0	0	0	0	0	0	1,780,000
24	03	Kosto lokale	0	0	Fakti	0	0	0	0	0	0	0	0
24	03	Kosto lokale	0	0	Angazhime	0	0	0	0	0	0	0	0
24	04	TVSH, Detyrim Doganor	0	0	Plani fillestar	0	0	0	0	0	0	0	0
24	04	TVSH, Detyrim Doganor	1,820,000	0	Plani i rishikuar	0	0	0	0	0	0	0	1,820,000
24	04	TVSH, Detyrim Doganor	0	0	Fakti	0	0	0	0	0	0	0	0
24	04	TVSH, Detyrim Doganor	0	0	Angazhime	0	0	0	0	0	0	0	0
24		Total	0	15,000,000	Plani fillestar	531,300,000	66,800,000	70,900,000	0	0	0	0	684,000,000
24		Total	3,600,000	11,400,000	Plani i rishikuar	521,300,000	66,800,000	80,500,000	400,000	1,500,000	0	0	685,500,000
24		Total	0	0	Fakti	303,569,374	46,345,918	45,556,289	292,166	421,200	0	0	396,184,947
24		Total	0	0	Angazhime	0	0	5,041,872	0	0	0	0	5,041,872
24		Ndryshimi ne vlerë absolute	3,600,000	11,400,000		217,730,626	20,454,082	34,943,711	107,834	1,078,800	0	0	289,315,053
24		Realizimi ne %	0	0		58	69	57	73	28	0	0	58



Emri: *V. G. G. G.*
 Firma: *[Signature]*
 Data: *22.09.2024*

Emri: *[Signature]*
 Firma: *[Signature]*
 Data: *[Signature]*

Aneksi 1.2 "Shpenzimet Buxhetore në Total Programi dhe Total Ministrie/Institucioni Buxhetor"

Periudha e Raportimit 8-2024

Kodi i Ministris	Kodi i Programi	Emërtimi i Programit	Viti	Tipi i Buxhetit	Art. 230	Art. 231	Art. 600	Art. 601	Art. 602	Art. 605	Art. 606	Total
24	01120	Veprimtaria Audituese e KLSH	2024	Plani fillestar	0	15,000,000	531,300,000	66,800,000	70,900,000	0	0	684,000,000
24	01120	Veprimtaria Audituese e KLSH	2024	Plani i rishikuar	3,600,000	11,400,000	521,300,000	66,800,000	80,500,000	400,000	1,500,000	685,500,000
24	01120	Veprimtaria Audituese e KLSH	2024	Shpenzime faktike	0	0	303,569,374	46,345,918	45,556,289	292,166	421,200	396,184,947
24	01120	Veprimtaria Audituese e KLSH	2024	Angazhime	0	0	0	0	5,041,872	0	0	5,041,872
24		Ndryshimi ne vler absolute	2024		3,600,000	11,400,000	217,730,626	20,454,082	34,943,711	107,834	1,078,800	289,315,053
24		Realizimi ne %	2024		0	0	58	69	57	73	28	58
24		Total i Ministrise/Institucionit	2024	Plani fillestar	0	15,000,000	531,300,000	66,800,000	70,900,000	0	0	684,000,000
24		Total i Ministrise/Institucionit	2024	Plani i rishikuar	3,600,000	11,400,000	521,300,000	66,800,000	80,500,000	400,000	1,500,000	685,500,000
24		Total i Ministrise/Institucionit	2024	Shpenzime faktike	0	0	303,569,374	46,345,918	45,556,289	292,166	421,200	396,184,947
24		Total i Ministrise/Institucionit	2024	Angazhime	0	0	0	0	5,041,872	0	0	5,041,872
24		Numri i punonjesve në Total	2024	Plani fillestar								0
24		Numri i punonjesve në Total	2024	Plani i rishikuar								0
24		Numri i punonjesve në Total	2024	Numri faktik								0

Drejtesia e Ekipit Menaxhues të Programit	Emri		Emri	
	Firma	<i>Çepova</i>	Firma	<i>Vetjona Çepova</i>
	Data		Data	<i>23.09.2024</i>



ANEKSI nr. 2 Raporti mbi Ekzekutimin e Buxhetit në nivelin e Programit të Buxhetit

Periudha e Raportimit 8-2024

në/lekë

Emri i Grupit		Kontrolli Lartë i Shtetit		Kodi i grupit		24		01120		Shpenzimet e Programit	
Emri i		Veprimtaria Audituese e KLSH		Kodi i programit		01120		01120		Shpenzimet e Programit	
Kodi i Programit	Emërtimi	Viti pararendës 2023		Periudha raportuese		Periudha raportuese		Periudha raportuese		Ndryshimi i Vjetor (Plan - Fakt)	% e realizimit
		Struktura e shpenzimeve në %	Shpenzime Faktike	Plani Vjetor i Rishikuar Viti 2024	Struktura e shpenzimeve në %	Plani Vjetor i Rishikuar Viti 2024	Struktura e shpenzimeve në %	Shpenzime Faktike të Periudhës/Progressit ve	Struktura e shpenzimeve në %		
(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7 (5-3))	(8)	(9)	(10 (5-8))	(11 (8/5))	
Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik											
EMËRTIME											
Emërtimi											
600	Paga	402,586,583.00	58	537,300,000.00	58	-10,000,000.00	303,569,374.00	58	217,730,626.00	58	
601	Sigurime Shoqërore	62,524,010.00	69	66,800,000.00	69	0	46,345,918.00	69	20,454,092.00	69	
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	71,423,959.90	57	70,900,000.00	57	0	45,556,289.00	57	34,943,711.00	57	
603	Subvencione	0.00	0	0	0	0	0.00	0	0	0	
604	Transferta Korente të Brendshme	0.00	0	0	0	0	0.00	0	0	0	
605	Transferta Korente të Huaja	116,035.00	73	400,000.00	73	400,000.00	292,166.00	73	107,834.00	73	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	643,117.00	28	1,500,000.00	28	1,500,000.00	421,200.00	28	1,078,800.00	28	
Nëntotali Shpenzime Korente											
		537,293,704.90	59	669,000,000.00	59	669,000,000.00	396,184,947.00	59	274,315,053.00	59	
230	Kapitale të Trupëzuara	1,816,700.00	0	0	0	0	0.00	0	3,600,000.00	0	
231	Kapitale të Trupëzuara	6,053,456.00	0	15,000,000.00	0	15,000,000.00	0.00	0	11,400,000.00	0	
Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm											
		7,870,156.00	0	15,000,000.00	0	15,000,000.00	0.00	0	15,000,000.00	0	
230	Kapitale të Trupëzuara	7,317,340.00	0	0	0	0	0.00	0	0	0	
231	Kapitale të Trupëzuara	0.00	0	0	0	0	0.00	0	0	0	
Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të huaj											
		7,317,340.00	0	0	0	0	0.00	0	0	0	
Totali i Shpenzimeve Kapitale		15,187,496.00	0	15,000,000.00	0	15,000,000.00	0.00	0	15,000,000.00	0	
Totali i Shpenzimeve Buxhetore të Programit		552,481,200.90	58	684,000,000.00	58	684,000,000.00	396,184,947.00	58	289,315,053.00	58	
Shpenzime Korente nga të Ardhurat Jashtë Limitit (Kap 06)		0.00	0	0	0	0	0.00	0	0	0	
